




Pranimi / Dorezuar Primito / Predato Received / Delivered	31.12.2021	1	viti god year
Organ / Bjesia Organ / Jedinica Org / Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtesa Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKDM/STCK	6474/2021		1/4



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A nr.985/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave në përbërje nga: Jeton Koca-kryetar, Ardita Haxhnikaj Demi dhe Arben Mehmeti-anëtarë, si dhe Avdyl Bektoshi Zyrtar i Lartë për bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, sipas Aktgjykimit A.nr.1104/19 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.112/2019 e datës 19.02.2019 të parashtruar nga ankuesi me adresë banimi Rr.“Mehmet Kollari” nr.38, Komuna e Vushtrrisë, kundër organit të punësimit - Këshilli Prokurorial i Kosovës, në çështjen juridike “kontestim konkursi”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nënparagrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datën 31.12.2021, mori këtë:

V E N D I M

- I. Refuzohet si e pabazuar ankesa me numër A.nr.112/2019 e datës 19.02.2019 e parashtruar nga ankuesi
- II. Mbetet në fuqi Vendimi me numër KA.Nr.05/2019 i datës 05.02.2019 i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Këshillit Prokurorial të Kosovës.

A r s y e t i m

Këshilli Prokurorial i Kosovës, me datë 07.12.2018 ka shpallur konkursin me numër reference: KPK/ZKPSH/ZMNV 007 për pozitën e punës “Zyrtar për Mbrojtje të Viktimave” në Zyrën për Mbrojtjen e Viktimave në Mitrovicë, në të cilin konkurs ka aplikuar edhe ankuesi

Këshilli Prokurorial i Kosovës, me datë 08.01.2019 ka bërë publik njoftimin për përzgjedhjen përfundimtare, sipas të cilit ankuesi nuk rezultoi si kandidat i suksesshëm dhe i njëjti nuk rekomandohet për emërim në Shërbim Civil.

I pakënaqur me njoftimin e datës 08.01.2019 lidhur me kandidatin e suksesshëm, ankuesi më datë 28.01.2019 ka parashtruar ankesë në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Këshillit Prokurorial të Kosovës. Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe



Ankesave i Këshillit Prokurorial të Kosovës me datë 31.01.2019 ka nxjerr Vendimin me numër KA.Nr.05/2019 përmes të cilit ka refuzuar si të pabazuar ankesën e ankuesit.

Kundër Vendimit me numër KA.Nr.05/2019 të datës 31.01.2019 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Këshillit Prokurorial të Kosovës, ankuesi me datë 15.02.2019 ka parashtruar ankesën me numër protokollit 857/2019 të regjistruar me numër A.nr.112/2019 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimet ankimor se vlerësimi i kualifikimit, aftësive dhe shkathtësive nuk është bërë me pike maksimale edhe përkundër faktit se i njëjti i ka 8 vite përvojë pune; Vlerësimi i testit me shkrim intervistës me gojë nuk është real; Koha e intervistimit për kandidatin fitues ka zgjatur vetëm 15-20 minuta për dallim nga kandidatet tjetër ku koha e caktuar ishte 30-40 minuta; Gjatë intervistës me gojë Kryesuesi i Komisionit ka dal jashtë 5-10 minuta, dhe nuk është e çartë si është bërë vlerësimi.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 21.02.2019, ankesën e ankuesit e ka proceduar për përgjigje në ankesë tek Këshilli Prokurorial i Kosovës. Ky i fundit me datë 01.03.2019 ka dërguar përgjigjen në ankesë se bashku me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 02.05.2019 përmes shkresës me numër të protokollit 2111/2019 e ka njoftuar ankuesin për pamundësinë e vendosjes lidhur me ankesën e datës 19.02.2020 për shkak të mungesës se kuorumit dhe të njëjtin e ka udhëzuar që t'i ndjek procedurën e përcaktuar me dispozitat e LKA-se. Ankuesi, kundër heshtjes administrative, me datë 10.05.2019 ka parashtruar padi pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative. Gjykata Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative përmes Aktgjykimit me numër A.nr.1104/19 ka detyruar Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil që të shqyrtojë dhe të vendos lidhur me ankesën e datës 19.02.2019 të parashtruar nga ankuesi [REDACTED]

Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave për marrjen e vendimit meritore ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokollit 857/2019 të datës 19.02.2019 të regjistruar me numër A.nr.112/2019 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimin KA.Nr.05/2019 të datës 31.01.2019 të Komisionit për Zgjedhjen e Kontesteve dhe Ankesave (KZKA); Ankesën e datës 24.01.2019, drejtuar Komisionit për Zgjedhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës; Formularin e regjistrimit të Ankesës Nr.857/2019 të datës 19.02.2019; Përgjigjen në ankesë 1078/2019, të datës 01.03.2019; Njoftim për përzgjedhjen përfundimtare, të datës:08.01.2018. Përmbledhja e vlerësimeve individuale e testit dhe intervistës; Deklarata për mosekzistim të konfliktit të interesit datë:28.12.2018; Testi me shkrim 28.12.2018; Vendimi Komisionit Përzgjedhës i Shërbimit Civil Nr. Prot. DSKPK/573/2018 i datës 21.12.2018; Ankesë drejtuar komisionit për Zgjedhjen e Kontesteve dhe Ankesave Nr.7005603 e datës 28.01.2019; Njoftimi i kandidateve të përzgjedhur ne listën e ngushte i datës 26.12.2018; Dëshmi për dorëzimin e aplikacionit me datë 24.12.2018; Kërkesa për punësim 20.12.2018; Diplomë e datës 26.06.2008, Certifikatën universitare; Letër motivuese; Letër rekomandim; Procesverbal i Mbledhjes se komisionit Për shqyrtimin e ankesave Nr.944 i datës 06.12.2012; Dëshmi për dorëzimin e Aplikacionit Nr.904 i datës 17.12.2018; Diplome Universitare e datës 10.07.2015 e lëshuar nga Fakulteti Juridik në Universitetin e Prishtinës; Vërtetimi i Gjykatës Themelore Nr.172/2016 i datës 19.04.2016,

Formular për vlerësimin e rezultateve në punë dhe Përgjigje në ankesë nga organi i punësimit e datës 01.03.2019, bashkë me shkresat e lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët, ka konstatuar se ankesa e ankuesit *është e pa bazuar, sepse:*

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ka shqyrtuar pretendimin ankimor të ankuesit lidhur me vlerësimin e kualifikimit, shkathtësive dhe aftësive dhe rrjedhimisht ka konstatuar se piket e fituara në fazën e vlerësimit të aplikacionit shërbejnë vetëm për të kaluar pragun e përcaktuar me qëllim të vazhimit me fazat tjera të rekrutimit, mirëpo të njëjta nuk mbledhen për dhënien e rezultatit përfundimtar. Andaj, duke u bazuar në shkresat e lëndës Kolegji ka gjetur se ankuesi në fazën e vlerësimit të aplikacioneve është vlerësuar nga Komisioni Përzgjedhës dhe mbi bazën e këtij vlerësimi i njëjti është përfshirë në listën e shkurtër për të vazhduar me fazat tjera të rekrutimit, kështu që pretendimi ankimor i ankuesit se nuk është bërë vlerësim real i kualifikimit, shkathtësive dhe aftësive nuk qëndron, dhe si i tillë pretendimi ankimor i ankuesit është i pa bazuar.

Kolegji duke iu referuar shkresave të lëndës, gjegjësisht formularit përmbledhës të vlerësimeve individuale të testit me shkrim dhe intervistës me gojë, ka gjetur se ankuesi në testin me shkrim është vlerësuar me 280 pikë, ndërsa në interviste me gojë ka mbledhur 291 pikë, duke mbledhur kështu 57.1% të pikëve në përgjithësi. Ndërsa kandidati i suksesshëm i rekomanduar për emërim I.A, në testin me shkrim dhe intervistën me gojë ka mbledhur 70.8 % të pikëve, kështu që Komisioni Përzgjedhës ka rekomanduar për emërim kandidatin me më shumë pikë të mbledhura në testin me shkrim dhe intervistën me gojë, siç parashihej me dispozitat e Rregullores Nr.02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil, përkatësisht nëni 40 paragrafi 1 ku përcaktohet se: *Në Shërbimin Civil emërohen kandidatet të cilët kanë arritur numrin me të madh total të pikëve në testin me shkrim dhe me gojë*, kështu që pretendimi ankimor i ankuesit në këtë kuptim është i pa bazuar.

Ndërsa lidhur me pretendimin ankimor të ankuesit se koha e intervistimit për të gjithë kandidatet ka zgjatur 30-40 minuta, ndërsa për kandidatin e përzgjedhur koha e intervistimit ka zgjatur 15-20 minuta, Kolegji vlerëson se ankuesit meqenëse i është lenë në shfrytëzim koha e përcaktuar për intervistë, 30-40 minuta, nuk kemi të bëjmë me shkelje të ndonjë të drejtë në ndaj të njëjtit, në rastin konkret. Ndërsa nuk është relevante fakti nëse ndonjë kandidat e ka menagjuar ndryshe kohën apo nuk e ka shfrytëzuar kohën e plotë të përcaktuar nga Komisioni Përzgjedhës. Po ashtu, në shkresa të lëndës, Kolegji nuk ka gjetur ndonjë dëshmi ku do të argumentohej fakti lidhur me pretendimin ankimor se gjatë kohës së intervistimit të ankuesit Kryesuesi i Komisionit Përzgjedhës ka dal jashtë 5-10 minuta, kështu që pretendimet ankimore në këtë kuptim janë të pa bazuara.

Andaj, duke marr parasysh se kriteret e konkursit për këtë pozite të punës kanë qenë: *Diplomë universitare – Fakulteti Juridik, dhe dy vite përvojë pune profesionale*, dhe meqenëse kandidati i suksesshëm i ka plotësuar kriteret e konkursit për faktin se i njëjti në kohën e aplikimit ka dorëzuar si dëshmi: Diplomën Nr.3387 të datës 10.07.2015 të lëshuar nga Universiteti i Prishtinës-Fakulteti Juridik, përmes të cilës i njëjti me datë 01.03.2015 ka marr titullin Jurist i Diplomuar, dhe dëshmitë mbi përvojën e punës: Vërtetimin e datës 31.12.2017 të lëshuar nga Avokati *lidhur me përvojën e punës prej datës 05.01.2017 – deri më datën 30.12.2017, Vërtetimin e datës 20.07.2018 të lëshuar nga Avokati lidhur me përvojën*

e punës prej datës 05.01.2018 deri me datën 20.07.2018, dhe Vërtetimin e datës 05.01.2017 të lëshuar nga Gjykata Themelore në Mitrovicë - Dega në Skenderaj, lidhur me përvojën e punës nga data 05.01.2016 deri më datën 31.12.2016, dhe meqenëse nuk janë gjetur shkelje sipas pretendimeve ankimore të ankuesit, Kolegji vlerëson se Komisioni Përzgjedhës pranë Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës, me rastin e rekomandimit të kandidatit të suksesshëm për pozitën e punës "Zyrtar për Mbrojtje të Viktimave" në Zyrën për Mbrojtjen e Viktimave në Mitrovicë, me numër reference KPK/ZKPSH/ZMNV 007, ka vepruar në përputhje me nenin 11 paragrafin 1 të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Kosovës, i cili përcakton që: "Pranimi në Shërbimin Civil të Kosovës bëhet në pajtim me parimet e meritës, aftësisë profesionale, paanshmërisë, mundësive të barabarta, mos diskriminimit dhe përfaqësimit të barabartë, në bazë të konkursit publik dhe pas verifikimit të zotësisë së veprimit të kandidatëve" dhe dispozitave të Rregullores Nr.02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil.

Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave, po ashtu konstaton se Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës, me rastin e nxjerrjes së Vendimit numër KA.Nr.05/2019 të datës 05.02.2019, ka vërtetuar drejte gjendjen faktike dhe drejte ka zbatuar ligjin material, duke vepruar kështu në pajtim me dispozitat e Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, dhe Rregulloren Nr.05/2011 për Procedurat e Zgjidhjes së Kontesteve dhe të Ankesave.

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hynë fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës
Lënda A.nr.985/2021, datë 31.12.2021

Ardyl BEKTESHI

Procesmbajtës

Jeton KOÇA

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dërgohet

- Ankuesit,
- Drejtorit të Përgjithshëm të Sekretariatit në Këshillin Prokurorial të Kosovës;
- Udhëheqësit të Personelit në Këshillin Prokurorial të Kosovës; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së